

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**KONCEPTET E TË MIRËS (EL-HAJR),
VIRTYTIT (EL-IHSAN)
DHE DREJTËSISË (EL-ADL)
NË KUR'ANIN FISNIK
dhe raporti i tyre me
ruajtjen e ambientit**



Konceptet e të mirës (*el-hajr*), virtytit (*el-ihsan*), dhe drejtësisë (*el-adl*) në Kur'anin Fisnik dhe raporti i tyre me ruajtjen e ambientit



DOC.DR.HFZ. HAJREDIN HOXHA
Doktor në Shkenca Kur'anore dhe Tefsir

Fakulteti i parimeve të fesë Islame
Universiteti islam Sulltan Sherif Ali
Brunei darussalam

Përktheu nga anglishtja: Edin Q. Lohja
Recensent: Edin Q. Lohja

Përmbajtje

Parathënie.....	2
Përse ky studim.....	4
Pjesa e parë: Koncepti i të mirës (<i>el-hajr</i>)	10
i) Meritat e tij.....	10
ii) Nocioni i veprave të mira (<i>es-salihat</i>) dhe domethënia e tij.....	12
iii) Raporti i <i>el-hajr</i> dhe <i>es-salihat</i> në ruajtjen e mjedisit.....	15
 Pjesa e dytë: Virtyti (<i>el-ihsan</i>) - Meritat, shpërblimi dhe raporti i tij me ruajtjen e mjedisit.....	17
i) Meritat e tij.....	17
ii) Shpërblimi i <i>ihsanit</i> dhe domethënia e tij.....	22
 Pjesa e tretë: Drejtësia (<i>el-adl</i>) - Meritat, shpërblimi dhe raporti i saj me ruajtjen e mjedisit.....	26
i) Meritat dhe shpërblimi i saj.....	26
ii) Raporti i saj me ruajtjen e mjedisit.....	32
Përfundim.....	34
Bibliografi.....	35

بسم الله الرحمن الرحيم

Në Emër të Zotit, Gjithmëshiruesit, të Plotmëshirshmit¹

Parathënie

Të gjitha lavdet dhe falënderimet janë për Zotin. Ne e madhërojmë Atë dhe i kërkojmë ndihmë. Kërkojmë mëshirën e Tij dhe synojmë strehim tek Ai nga e keqja e veteve tona dhe ultësia e veprave tona. Kushdo i udhëzuar prej Tij nuk humbet kurrë, dhe këdo që Ai lejon të devijojë nuk do të gjejë udhëzim. Dëshmoj se askush nuk ka të drejtë të adhurohet përveç Zotit, që nuk ka shok, dhe dëshmoj se Muhammedi është shërbëtori dhe i Dërguari i Tij. Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të e Familjen e tij, si dhe Shoqëruesit e tij, dhe mbi të gjithë ata që i ndjekin me devotshmëri deri në Ditën e Gjykimit.

Lexues të dashur, Kur'ani Fisnik është fjala e shpallur e fundit e Zotit të Plotfuqishëm, dhe burimi parësor i besimit dhe veprimit të çdo muslimani. Ai trajton tema lidhur me qeniet njerëzore: urtinë, doktrinën, ndërveprimet, ligjin, etikën, moralin, marrëdhëniet shoqërore dhe ndërkombëtare, por tema e tij themelore është raporti ndërmjet Zotit dhe krijesave të Tij. Njëkohësisht, ai ofron udhëzime dhe mësim të detajuara për një shoqëri të drejtë, sjellje të duhur njerëzore, dhe një sistem të drejtë ekonomik.

Profesor Sejjid Kutb thotë: "*Sheri'ati përfshin bindjet dhe konceptet islame lidhur me cilësitë e Zotit, natyrën e jetës, çfarë shtë e dukshme dhe çfarë është e fshehur në të, natyrën e njeriut dhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre. Në mënyrë të ngjashme, ai përfshin çështjet politike, shoqërore dhe ekonomike si dhe parimet e tyre, me qëllim që ato të pasqyrojnë nënshtrim të përsosur vetëm ndaj Zotit. Ai përfshin edhe çështje ligjore (që sot quhet "Sheri'at", ndërkohë që kuptimi i vërtetë i Sheri'atit në Islam është shumë më i gjerë). Ai merret me moralin, edukatën, vlerat dhe standartet e shoqërisë, sipas të cilave maten personat, veprat dhe ngjarjet. Ai trajton gjithashtu me të gjitha aspektet e dijes, artit dhe shkencës. Në të gjitha këto nevojitet udhërrëfimi i Zotit, ashtu siç nevojitet ai në çështje ligjore...*"²

¹ Ky studim është prezentue në seminarin ndërkombëtar me titull: Islami dhe ruajtja e ambientit në Brunei me datën 05.10. 2010

² *Milestones-Me'â'lim fi Al Tariq*, ed. A. B. El Mehri, Birmigham: Maktabah Publishers, 2009, f. 56.

Islami është një mënyrë sistematike të jetuari dhe pret nga njerëzit që ta ruajnë mjedisin për një së arsyesh. Zoti i Madhërishëm thotë në Kur'anin Fisnik:

﴿هُوَ أَنشَأَكُم مِّنَ الْأَرْضِ وَاسْتَعْمَرَكُمْ فِيهَا﴾ [هود: 61]

"Ai është që ju ka bërë nga toka e ju ka vendosur në të"³ (Hud:61)

Mjedisi është krijimi i Zotit. Krijimi i kësaj toke dhe të gjitha burimeve natyrore të saj është shenjë e urtisë, mëshirës dhe fuqisë së Tij. Ndaj, të kuptuarit e kësaj shërben për zhvillimin e vetëdijes njerëzore dhe të Krijuesit të gjithësisë. Muslimanët urdhërohen ta mbrojnë dhe ruajnë mjedisin dhe gjithçka që i përket Zotit të madhërishëm. Duke vepruar kështu, ata mbrojnë krijesat e Zotit, të Cilin e madhëron dhe lavdëron çdo gjë në këtë univers. Zoti Fuqiplotë thotë:

﴿تَسَبَّحُ لَهُ السَّمَاوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَن فِيهِنَّ وَإِن مِّن شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِن لَّا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا﴾ [الإسراء: ٤٤]

"Shtatë qiejt dhe toka, dhe gjithçka në to e madhëron Zotin: çdo gjë e feston lavdinë e Tij; porse prapë ju nuk ua kuptoni atyre madhërimin e Tij! Vërtet Ai është i Durueshëm, Shumëfalës!" (el-Isra: 44)

Sistemi i jetës në Islam mbështetet në konceptin e së mirës (el-hajr). Prandaj pritet që Islami ta mbrojë mjedisin me të kuptuar se një mbrojtje e tillë është e mirë në vetvete. Kur'ani thotë:

﴿فَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ وَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ﴾ [الزلزلة: ٧-8]

"Kushdo që bën mirë sa pesha e një thërmije do ta shohë. Dhe kushdo që bën keq sa pesha e një thërmije do ta shohë." (el-Zelzele: 7- 8).

Një tjetër çështje me rëndësi është se të gjitha raportet ndërnjerëzore në Islam duhen mbështetur në konceptin i drejtësisë (el-adl) dhe virtytit (el-ihسان), e jo në fitimin material ose ekonomik. Kur'ani e thekson fuqimisht këtë koncept në vargun:

³ Prof. Kutb shkruan në Tefsirin e tij: "...Kjo i referohet prejardhjes së racës njerëzore si dhe faktit se çdo qenie njerëzore varet nga ushqimi që merr nga toka, nga elementet e disponueshme në të, për rritjen e tij. Megjithë këtë prejardhje, ata vihen kujdestarë të tokës dhe marrin detyrën e ndërtimit të saj..." *In the Shade of the Qur'an*, Birmigham: Maktabah Publishers, 2009, Vol. 9, p. 224.

﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ﴾ [النحل: 90]

“Zoti urdhëron drejtësi dhe mirësi” (en-Nahl: 90)

In Islam, nga njerëzit pritet që ta mbrojnë mjedisin sepse asnjë krijesë tjetër nuk është e aftë për një detyrë të tillë. Njerëzit janë qeniet e vetme të cilëve Zoti ua ka besuar përgjegjësinë e kujdesjes për tokën. Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿إِنَّا عَرَضْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْجِبَالِ فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلْنَهَا وَأَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ إِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا جَهُولًا﴾ [الأحزاب: 72]

Ne ua ofruam amanetin qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie). (el-Ahzab: 72)

Ky amanet shihet nga Islami si aq i rëndë dhe i vështirë saqë asnjë krijesë tjetër nuk e mori përsipër. Ky punim do të hedhë dritë mbi ruajtjen e mjedisit nga këndvështrimi kur'anor, duke iu referuar parimeve të lartpërmendura kur'anore, që lidhen drejtpërsëdrejti me ruajtjen e krijimit të Zotit.

Përse ky studim

Dijetarët kanë vërejtur se përgjatë viteve, mjedisi ynë po përballlet me një kërcënim të pazakontë. Lumejtë janë ndotur me kimikate dhe lëndë toksike, pyjet po zhduken me një ritëm alarmues që sjell një degradim mjedisor të tmerrshëm. Barazpesha në oksigjen dhe ujë e mjedisit, e cila është tejet e rëndësishme për të ruajtur jetën e qytetërimit mbi tokë, po humbet. Qindra miliona dollarë janë shpenzuar në nisma të ndryshme të ndërmarra në konferenca dhe seminare kombëtare dhe ndërmkombëtare, siç u pa më 2009 në Bruksel. Pas diskutimeve të gjata, pjesëmarrësit nuk arritën asnjë përfundim. Ata nuk ishin në gjendje të gjenin mënyra të përbashkëta për t'i mbrojtur njerëzit nga pasojat e ngrohjes globale mbi mjedisin tonë të përbashkët.

Prof. Sejjid Kutb shkruan: "...Koncepti islam i gjithësisë e përkufizon raportin e njeriut me pjesën tjetër të universit dhe Krijuesin e tij. Tema e tij kryesore është natyra e njeriut dhe vendi i tij në gjithësi, qëllimi i jetës së tij, funksioni i tij dhe vlera e vërtetë e jetës së tij. Të gjitha këto përfshihen në

konceptin islam, i cili nuk është thjesht një ide abstrakte, por një forcë gjalluese motivuese që ndikon emocionet dhe veprimet e njeriut."⁴

Kështu, përpara se t'u drejtohem vargjeve kur'anore si dhe mësimëve dhe koncepteve sakrale të tij për të gjetur udhëzimet dhe zgjidhjet e duhura për ruajtjen e mjedisit, do të dëshiroja të cek disa çështje bashkëkohore filozofike dhe shkencore që e kanë mjeruar jetën e njerëzimit me teoritë e tyre të sajuara që e kanë shqitur jetën tonë nga mësimet islame. Ndarja mes fesë dhe jetës njerëzore quhet deizëm. Ai përkufizohet nga dijetarët si më poshtë:

“Deizmi është pikëpamja se feja e vërtetë është feja natyraliste... Shumica e deistëve e kanë flakur fenë e shpallur si trillim. Zoti dëshiron që krijesat e Tij të jenë të lumtue dhe ka urdhëruar virtytin si mjetin për arritjen e kësaj... Kështu që shpëtimi nuk mund të varet nga ndonjë shpallje e veçantë. Feja e vërtetë është shprehje e një natyre universale njerëzore, thelbi i të cilës është i njëjtë në të gjitha kohërat dhe vendet. Traditat fetare si Krishtërimi dhe Islami burojnë nga lehtëbesimi, tirania politike dhe aftësia e klerit, të cilat e shthurin arsyen dhe e ndotin fenë natyraliste. Deizmi është kryesisht një dukuri e shekujve XVII dhe XVIII i cili spikati më shumë në Angli. Ndër deistët më të njohur anglezë ishin John Toland (1670-1722), Anthony Collins (1676-1729) dhe Mathew Tindal (1657-1733). Nga fundi i shekullit XVIII, ky term filloi të nënkuptonte besimin në një “Zot mungues” që e krijon botën, vendos ligjet e saj, pastaj ia lë atë vetvetes.”⁵

Valët e kohës moderne në Evropë në fillim të shekullit XVIII si dhe pionierët e iluminizmit filozofik i kanë ndarë mësimet hyjnore nga jeta jonë, duke u varur në koncepte racionaliste.⁶ Kjo lëvizje pati efektin e saj negativ ndaj jetës socio-fetare. Ajo solli idenë e sekularizmit që i ndan mësimet Hyjnore të fesë nga të gjitha aspektet e jetës tonë. Ky i kuptuar i shtrembër i filozofisë së jetës në këtë gjithësi pa mësim Hyjnore çoi në zhvillimin e sistemeve të sajuara nga njeriu me të metat e tyre.

Studiuesit kanë vënë në pah se “Qasja mbizotëruese evropiane para Iluminizmit ndaj politikës dhe fesë theksonte epërsinë hierarkike të autoritetit fetar mbinatyror. Ajo i përmbahej shpalljes hyjnore dhe traditës, Kishës dhe autoritetit klerik. Monarkia dhe institucionet politike buronin dhe e merrnin legjitimitetin duke iu referuar autoritetit mbinatyror dhe fetar. Mbështetësit e

⁴ Qutb, *Milestones*, p. 56

⁵ Audi, Robert; *The Cambridge Dictionary of Philosophy*, Cambridge University Press, 1995, p. 188.

⁶ See: *The Slogan: Back to the Qur'an and Sunnah - A Comparative study of the responses of Hasan Hanafi – Abid Al Jabiri and Nurcholish Madjid*, - A Ph.D. dissertation written by: Yudia Eahyudi, The Institute of Islamic Studies, McGill University, Montreal, Canada, 2002, pg: 20-50.

Iluminizmit e flakën këtë qasje nda politikës dhe fesë duke mbështetur arsyen dhe natyrën, jo sferën mbinatyrore si burim parësor... Ata theksuan arsyetimin kritik, ligjet e natyrës, objektivitetin, dhe universalitetin; botëkuptimin shkencor; progresin; të drejtat e natyrshme, lirinë dhe barazinë; dobinë; tolerancën; dhe çlirimin nga bestytnitë, iracionaliteti, dhe të varurit nga forma të tjera të autoritetit të jashtëm.”⁷

Po ashtu, analistë muslimanë kanë vënë në dukje se: “Çarja mes shpirtërores dhe ‘shkencore’ u importua në mendjen dhe tokën muslimane me futjen e kulturës materiale, industriale. Kjo pati një efekt dërmues mi kulturën vendase dhe mjedisin. Si vlerat isalme, ashtu edhe ato industriale duhen rihetuar për të nxjerrë prej tyre një sistem vlerash që u përshtatet qenieve njerëzore, pa kundërshtuar bazën e Islamit (Kur'anin dhe Sunnetin), si dhe elementet mjedisore që ai mbështet... Masa e njerëzve në botën muslimane po përjeton dukurinë mbarëbotërore të ‘kërkimit të rrënjëve fetare’ që mund të përdoret për zgjidhjen e jo për krijimin e problemeve.

Zgjidhja e propozuar është kthimi⁸ në raportin tradicional mes njerëzve dhe tokës, si dhe njerëzve dhe elementeve të tjera të ekosistemit, dhe ndofta më thelbësisht mes vetë njerëzve.”⁹

Analistë të tjerë muslimanë thonë: “...Shumë studiues modernë ia vënë fajin themelit filozofik të mendimit modern. Për shembull, Sterling (1990) mendon se problemi mbarëbotëror nisi për shkak të eklipsit të botëkuptimit të hershëm të Krishtëritit mesjetar. Ky eklips ndodhi kur Kisha nuk arriti të ofronte më një këndvështrim intelektual paralel ndaj mendimtarëve si Galileo, Bacon, Descartes dhe Neëton. Botëkuptimi i ri sekular u bë materialist pa i pranuar fare koncepte të tilla si vlera, shpirti, ndjenja, emcionet, intuita dhe qëllimet e brendësishme.¹⁰ ...Qëndrimi islami ndaj mjedisit nuk kufizohet thjesht te prania e Zotit kudo, por edhe tek përmasat e mëposhtme. Duke iu nënshtruar Zotit, Islami shtron themelin e raportit mes

⁷ Wuthnow, Robert; *The Encyclopedia of Politics and Religion*, Rutledge, United Kingdom, London, 1998, pg. 233-234

⁸ See also: The Slogan: *Back to the Qur'an and Sunnah- A Comparative study of the responses of Hasan Hanafi – Abid Al Jabiri and Nurcholish Madjid*, - A Ph.D. thesis written by: Yudia Eahyudi, The Institut of Islamic Studies, McGill University, Montreal, Canada, 2002, pg: 20-50.

⁹ Refer to: Nasr, S.H. (1978), *Islamic Cosmological Doctrines* (London, Thames and Hudson). Also see: http://www.lamp.ac.uk/trs/staffgallery/mail_paper.html, broësed: 25.12.2009.

¹⁰ See also: *Juan de Segovia and Western Perspectives on Islam in the Fifteenth Century*, A Ph.D, dissertation, written by: Anne Marie Wolf, University of Minnesota, 2003, pg:36-80

qenieve të fundme njerëzore dhe Hyjnisë, sekulares dhe sakrales.¹¹

Gjatë kërkimeve të mia për këtë temë, ndesha një trajtesë të rëndësishme të Dr. Kareem Ghoneim, i cili m'u duku shumë i dobishëm nga pikëpamja islame dhe ndaj po e citoj. Ai shkruan:

“Sipas shkencëtarëve dhe filozofëve¹² njeriu konsiderohet si faktori kryesor në prishjen e barazpeshës natyrore të gjithësisë. Njeriu ndërhyr me ose pa dashje në ekosistemet e tokës duke ia prishur rendin e përsosur dhe renditjen e përpiktë... Rreziqe të rënda shfaqen në ndotjen e ajrit, ujit, dheut, hapësirës dhe të tjerëve, si dhe shfrytëzimi i paarsyeshëm i burimeve mjedisore, dhe shpërndarja e pabarabartë e vendbanimeve njerëzore. Të gjitha këto kanë sjellë probleme të ndryshme... Prishësit e tokës, qofshin mohues të Zotit, ushtrues të padrejtësisë ose kundërshtues të ligjeve universale, përmenden në vargjet e mëposhtme kur'anore:

﴿وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يُعْجِبُكَ قَوْلُهُ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَيُشْهَدُ اللَّهُ عَلَى مَا فِي قَلْبِهِ وَهُوَ أَلَدُّ الْخِصَامِ وَإِذَا تَوَلَّى سَعَى فِي الْأَرْضِ لِيُفْسِدَ فِيهَا وَيُهْلِكَ الْحَرْثَ وَالنَّسْلَ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الْفُسَادَ﴾ [البقرة: 204-205]

Ka ndonjë njeri (hipokrit), fjalët e të cilit në jetën e kësaj bote ta bëjnë qejfin dhe që betohet në Allahun për atë që mban në zemër, por që, në të vërtetë, është kundërshtari (yt) më i betuar. E, kur largohet, përpiqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë. Por Allahu nuk e do shkatërrimin. (el-Bekareh: 204 -205)

Egoizmi dhe agresioni e ka mposhtur njerëzimin,¹³ dhe ata janë kthyer në prishës të tokës, atmosferës dhe hapësirës pranë Tokës. Zoti thotë:

﴿ظَهَرَ الْفُسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ لِيُذِيقَهُمْ بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ﴾ [الروم: ٤١]

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).” (er-Rum: 41).

¹¹ Mawil Izzi Dien, *Journal of Beliefs & Values* No 1, 1997, Carfax University of Wales Lampeter, pp. 70-85.

¹² See also: Beaumont, P., Blake, G.H. & Eag staff, J.M. (1978) *The Middle East, A Geographical study* (London, Wiley), pp. 130-145.

¹³ Izzdien Dien, M. (1990) *Islamic environmental ethics, law and society*, in: J.R. Engel & J.G. Engel (eds) *Ethics of Environment and Development* pp.189-198 (London, Belhaven). For more details about these issues refer also to: <http://www.captiveminds.org/env/ecom>, browsed: 20.10.2010

Kjo është krejtësisht e vërtetë. Bota është bërë për shumë njerëz një rast i artë për të rritur pasurinë, kënaqësinë dhe luksin e tyre, duke shpërdoruar krijimin e Zotit dhe urtinë për të cilën është krijuar kjo gjithësi. Kjo mbrojtje e mjedisit e ka humbur besueshmërinë dhe domethënien e saj nga seminare dhe konferenca ndërkombëtare të padobishme. Njerëzit nuk janë ndërgjegjësuar akoma dhe nuk ka shumë shpresë për përmirësim. Mesa duket, njerëz të çdo feje, race dhe etnie duhet t'i drejtohen thirrjes së tyre shpirtërore për ta ndalur këtë prapësi dhe shfrytëzimin negativ të mjedisit.¹⁴

Në librin e tij për rëndësinë e mjedisit dhe konceptet islame të jetës, Prof. Muhammad Abdullah Suhaïm shkruan: "Kur shihni tokën dhe mënyrën se si është krijuar, do të vëreni se ajo përbën ndër shenjat më të mëdha të Krijuesit të saj. Zoti e ka bërë vendprehje dhe shtrat, duke ua nënshtuar shërbëtorëve të Tij. Ai u siguron prej saj furnizimin, mbajtjen dhe burimet e jetesës, duke krijuar mbi të rrugë dhe shtigje për të përmbushur nevojat e tyre. Ai e ka fiksuar fort me male, të cilat i ka bërë si shtylla për ta mbrojtur tokën nga dridhjet. Ai e shtron atë, e zgjat atë dhe e shtrin, duke e bërë marrëse për të vdekurit në brendësinë e saj. Syprina e saj është vendqëndrim për gjallesat, ndërsa brendësia e saj vendprehje për të vdekurit.

Pastaj vëreni orbitën e saj rret diellit, hënën, yjet dhe zodiakët, dhe shikoni se si sillet rrotull boshtit të vet deri në fund të kohës në këtë renditje të duhur, dhe shikoni ndryshimet në natë, ditë, nxehtësi dhe ftohtësi që vijnë nga këto lëvizje të mrekullueshme; si dhe përfitimet që sjellin për të gjitha llojet e kafshëve dhe bimëve si dhe gjithë çfarë ekziston mbi tokë. Pastaj thellohuni rreth krijimit të qiellit dhe vërejeni prapë; do të shihni se është ndër shenjat më të mëdha të Zotit në lartësi, gjerësi dhe qëndrueshmëri. Nuk ka shtyllë nën të dhe mbajtës mbi të, por ajo mbahet nga fuqia e pafundme e Zotit, që i mban qiejt dhe tokën pa kolapsuar.

Kur vëreni gjithësinë, përbërja e pjesëve të saj është në renditjen më të mirë, çka tregon gjithfuqinë e përsosur të Krijuesit të tyre dhe dijen, urtinë dhe mirësinë e Tij të plotë, do të konkludoni se ajo është si një ndërtesë e lartuar ku të gjitha kërkesat janë siguruar që më parë. Qielli është ngritur me çatinë e vet mbi të; toka është bërë si vendprehje dhe qilim për banorët e saj; dielli dhe hëna janë si llampa që ndriçojnë tokën; nërsa yjet janë pishtarë dhe stoli të tij që orientojnë udhëtarët në shtigjet e tyre nëpër botë. Xhevahirët dhe mineralet e fshehura në tokë si thesare të përgatitura janë bërë të gjitha për qëllimet që u shkojnë më për shtat. Të gjitha llojet e bimëve dhe

¹⁴ See: *Islamism and the Quest for Alternative Modernities*, a Ph.D. dissertation by Bahrooz Ghamari-Tabrizi, Santa Cruz -University of California, June 1998, ff. 21-36.

kafshëve përgatiten për atë që ato janë më të mira. Disa kafshë janë të përshtatshme për nise, disa për qumësht, disa për ushqim e disa për rojë. Dhe Ai e ka bërë njeriun kontrolluesin e tyre, sinjëmbret të autorizuar mbi to."¹⁵

Meqenëse tema e këtij punimi meret me parimet hyjnore se si të ruhet ky mjedis i mrekullueshëm, Zoti i madhërishë na ka ftuar t'i drejtohem Librit të Tij famëlartë, Kur'anit Fisnik dhe Sunnetit të të Dërguarit të Tij për të kërkuar zgjidhje konkrete për krizën e tanishme mjedisore në nivel lokal dhe global. Zoti Fuqplotë thotë:

﴿إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا﴾ [الإسراء: 9].

"Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh." (el-Isra':9)

Në krerët vijues do të hedhim dritë mbi disa ajete të Kur'anit për të shikuar vlerat e tij shpirtërore, shoqërore dhe etike.

¹⁵ as-Suhaym, Muhammad bin Abdullaah, *Islam: Its Foundations And Concepts*, tr. Abdur-Raafi Adeëale Imaam, Muslim World League, Al-Madinah Al-Munawwarah.

Pjesa e parë: Koncepti i së mirës (el-hajr) në Kur'an**i) Meritat e tij**

Ajetet e mëposhtme na tregojnë qartë domethënien, ndikimin dhe meritat e veprave të mira të njerëzve ndaj njëri tjetrit në shoqëri, pavarësisht nga prapavija e tyre fetare, etnike dhe racore. Këto ajete hyjnore tregojnë qartë thirrjen e Krijuesit tonë për të shpejtuar në çdo vepër të mirë dhe për të ndaluar të keqen dhe të ndaluarën. Zoti mëshirëplotë përshkruan në shumë vende në Librin e Tij fisnik veçoritë e të dërguarve të Tij dhe i thërret besimtarët që të ndjekin gjurmët e tyre:

1- ﴿أُولَئِكَ يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَهُمْ لَهَا سَابِقُونَ﴾، [المؤمنون: 61]

"Ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët."
(el-Mu'minun: 61)

2- ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا وَاعْبُدُوا رَبَّكُمْ وَافْعَلُوا الْخَيْرَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾
[الحج: 77]

"O besimtarë! Përkuluni dhe përlununi në sexhde (para Allahut)!
Adhuroni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira për të arritur shpëtimin!!"
(el-Haxh: 77)

3- ﴿وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾، [آل عمران: 104]

"Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara!
Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit. " (Al-i Imran: 104)

4- ﴿فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ أَيْنَ مَا تَكُونُوا يَأْتِ بِكُمْ اللَّهُ جَمِيعًا إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾
[البقرة: 148]

"... Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t'ju mbledhë të gjithëve; Ai është i Fuqishëm për çdo gjë." (el-Bekare: 148)

- 5 ﴿ وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِمْ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءَ الزَّكَاةِ وَكَانُوا لَنَا عَابِدِينَ ﴾ [الأنبياء: 73]

"... Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuam që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan. " (el-Enbija': 73)

- 6 ﴿ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَأُولَئِكَ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴾ [آل عمران: 114]

"... Ata besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët." (Al-i Imran: 114)

- 7 ﴿ إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ ﴾، [الأنبياء: 90]

"These (three) were ever quick in emulation in good works; they used to call on Us with love and reverence, and humble themselves before Us" (el-Enbija': 90)

- 8 ﴿ ثُمَّ أَوْرَثْنَا الْكِتَابَ الَّذِينَ اصْطَفَيْنَا مِنْ عِبَادِنَا فَمِنْهُمْ ظَالِمٌ لِنَفْسِهِ وَمِنْهُمْ مُقْتَصِدٌ وَمِنْهُمْ سَابِقٌ بِالْخَيْرَاتِ يُاذِنُ اللَّهُ ذَلِكَ هُوَ الْفَضْلُ الْكَبِيرُ ﴾ [فاطر: 32]

"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit a.s.). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe." (Fatir: 32)

- 9 ﴿ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴾ [المائدة: 48]

"Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti. " (el-Ma'ide: 48)

Siç pamë, Zoti Fuqplotë na ka bërë thirrje të përpigemi dhe garojmë në vepra të mira, për të arritur vlera të larta morale. Lidhur me këtë, mufesirët kanë theksuar se termi drejtësishtëmëri (*es-salihat*) është një tjetër nocion që lidhet ngusht me konceptin e të mirës (el-hajr ose el-hajrat) në Kur'an. Prandaj, është e arsyeshme në këtë rast që t'u drejtohem disa ajeteve të tjera që lidhen me veprat e mira (*es-salihat*) për të parë raportin e tyre të drejtpërdrejtë dhe impaktin në jetën tonë.

ii) Nocioni i veprave të mira (*es-salihat*) dhe domethënia e tij

Prof. Ahmed Sheuki el-Fangari është i mendimit se:

"Islami dallon nga fetë e tjera në atë që ai merret si me këtë jetë ashtu dhe me tjetrën. Ai është feja e vetme që ka ndërtuar një shtet dhe një shoqëri mbi tokë. Kësisoj, të gjitha udhëzimet për administrimin e një shoqërie të tillë zbriten drejtpërsëdrejti nga qielli. Disa kanë të bëjnë me sistemin sundues, disa me ndërveprimet shoqërore dhe ekonomike, krahas regjimit higjenik. Qëllimi i regjimit higjenik në Islam është krijimi i një bashkësie të shëndetshe dhe immune ndaj sëmundjeve infektuese dhe një individ të shëndetshëm (në trup dhe mendje) i cili është i aftë të kuptojë dhe zbatojë mesazhin e Zotit dhe t'ia përcjellë atë krejt botës..."¹⁶

Ajetet e mëposhtme nga Kur'ani Fisnik shpalosin qartë shpërblimin e madh që ka përgatitur Zoti i Madhërishëm për shërbëtorët e Tij nëse i përmbushin urdhrat e Tij dhe kryejnë vepra të mira. Ka një lidhje të ngushtë mes tyre. Të dyja terminologjitë duhen kuptuar si një koncept i plotë, si një trup, ato plotësojnë njëra tjetrën. Për të tillët do të ketë një lumturi, begati, shpërblim i padyshimtë, falje, furnizim, gëzim... Ata janë më të mirët e të gjitha krijesave, etj. Zoti Mëshirëplotë thotë:

1- ﴿الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ طُوبَىٰ لَهُمْ وَحُسْنُ مَآبٍ ۖ﴾، [الرعد: 29]

"Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka çdo mirësi dhe vendbanim të mrekullueshëm!" (al-Ra'd: 29)

¹⁶See: Sterling, S.R. (1990), *Towards an Ecological World view in: J.R.Engel & J.G. Engel, (eds) Ethics of Environment and Development*, pp. 77-96 (London, Belhaven). Po ashtu, shih: www.islamset.com/hip/Al-Fangary.html#6, browsed: 01.01.2010

2- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ هُمْ جَنَّاتُ النَّعِيمِ﴾ [لقمان: 8]

"Me të vërtetë, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të gjenden në kopshtet e dhuntisë..." (Lukman: 8)

3- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ هُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ﴾ [فصلت: 8]

"Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që do të kenë shpërblim të pandërprerë." (Fussilet: 8)

4- ﴿الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ هُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ﴾ [الحج: 50]

"Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje e dhunti fisnike." (el-Haxh: 50)

5- ﴿فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَهُمْ فِي رَوْضَةٍ يُحْبَرُونَ﴾ [الروم: 15]

"Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gëzojnë në kopshtin e Xhenetit." (er-Rum: 15)

6- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَٰئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّةِ﴾ [البينة: 7]

"Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira." (el-Bejneh: 7)

7- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَيَجْعَلُ لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا﴾ [مریم: 96]

"Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri." (Merjem: 96)

8- ﴿وَمَنْ يَأْتِهِ مُؤْمِنًا قَدْ عَمِلَ الصَّالِحَاتِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الدَّرَجَاتُ الْعُلَىٰ﴾ [طه: 75]

"Ndërsa kush paraqitet tek Ai si besimtar e që ka bërë vepra të mira, do të ngrihet në shkallë të larta" (Taha: 75)

9- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَانَتْ لَهُمْ جَنَّاتُ الْفِرْدَوْسِ نُزُلًا﴾ [الكهف: 107]

"Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë për banesa kopshtet e Firdeusit," (el-Kahf: 107)

- 10- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا﴾ [الكهف: 30]

"Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmirëve",

(el-Kahf: 30)

- 11- ﴿وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ﴾ [البقرة: 82]

"Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë." (el-Bekare: 82)

- 12- ﴿فَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَا كُفْرَانَ لِسَعْيِهِ وَإِنَّا لَهُ كَاتِبُونَ﴾ ، [الأنبياء: 94]

"Atij që bën vepra të mira dhe është besimtar, përpjekja nuk do t'i mohohet. Dhe këtë Ne ia shënojmë atij." (el-Enbija': 94)

- 13- ﴿وَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَيُوَفِّيهِمْ أُجُورُهُمْ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ﴾، [آل عمران: 57]

"Ndërsa atyre që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti do t'u japë shpërblimin e merituar. Allahu nuk i do punëmbropshtët." (Al-i Imran: 57)

- 14- ﴿أَمْ يَجْعَلُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَالْمُفْسِدِينَ فِي الْأَرْضِ أَمْ يَجْعَلُ الْمُتَّقِينَ كَالْفُجَّارِ﴾ [ص: 28]

"A t'i trajtojmë njëlloj ata që besojnë e bëjnë vepra të mira dhe turbulluesit në Tokë?! A t'i trajtojmë njëlloj njerëzit e devotshëm dhe njerëzit e mbrapshtë?!" (Sa'd: 28)

- 15- ﴿الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَالْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا﴾، [الكهف: 46]

"Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim)" (el-Kahf: 46)

-16 ﴿إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا﴾، [الإسراء: 9]

"Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh." (**el-Isra': 9**)

iii) Raporti i el-hajr dhe es-salihat me ruajtjen e mjedisit

Nga çfarë u tha mund të nxirren mësimë dhe udhëzime të rëndësishme. Allahu i Madhëruar i thërret qartë besimtarët muslimanë, si dhe krejt njerëzimin, falë universalitetit të Kur'anit, pavarësisht nga etnia e tyre, se të gjithë ata që veprojnë të mirën dhe bëjnë veprime të drejtësishme, që i japin punë të kualifikuar shoqërisë, që gjejnë mënyrat më të mira për ruajtjen e mjedisit, të njerëzve, të vendit, si dhe të atyre që luftojnë shthurjen morale, natyrore, dhe ekonomike me të gjitha mjetet... të gjithë ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm, Zoti do t'ua japë shpërblimin e tyre; kushdo që bën ndonjë vepër mirësie dhe ka besim – përpjekja e tij nuk do të refuzohet: Ne do t'ia regjistrojmë në favor të tij; sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të drejtësishme, vërtet ne nuk do t'ua humbim shpërblimin e askujt që bën vepra të drejtësishme; atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të drejtësishme i Plotmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri; ata që kanë besim dhe bëjnë vepra të drejtësishme – ata janë më të mirët e krijimit...etj.

Me fjalë të tjera, në vargjet kur'anore të mësipërme ka një thirrje hyjnore zgjimi për bashkësinë ndërkombëtare, muslimanët, për të nxituar në vepra të mira dhe për të mbrojtur mjedisin me të gjitha mënyrat. Mirëqenia dhe lumturia e njerëzimit në këtë jetë dhe në tjetrën do të arrihen duke ndjekur konceptet sakrale të Kur'anit.

Lidhur me këtë mund të shohim se raporti ndërmjet koncepteve *el-hajr*, *es-salihat*, dhe ruajtjes së mjedisit. Tërë njerëzimi duhet të ketë besim të fortë në urdhëresat dhe udhëzimet kur'anore. Fuqia, dashuria dhe pasioni i mbrojtjes duhet të dalë nga zemra e tyre, jo nga

konsiderata materialiste. Kushdo që i zbaton këto parime hyjnore në praktikë do t'i shohë efektet pozitive brenda pak kohësh, dhe njerëzit do të përmbahen ose të paktën pakësojnë ndotjen e mjedisit.

A është pra ndotja e lumejve me kimikat e dëshirueshme; a është ajo një vepër mirësie? Absolutisht jo!

Shkatërrimi dhe djegia e pyjeve, vepër e mirë? Absolutisht jo; siç po shohim sot djegien e pyjeve në Rusi, Portugali, Spanjë etj.

Zhbalancimi i raportit të oksigjenit me ujin, a është vepër e mirë? Absolutisht jo.

Vendosja e plehrave në kazanin e gabuar nuk mund të konsiderohet vepër mirësie.

Mosmbajtja në pastërti e vetes, dhomës, zyrës, punës, universitetit, rrugës, shtëpisë, parkut... a mund të konsiderohet vepër mirësie?

Përgjigjja është e thjeshtë dhe shumë e thjeshtë: jo !

﴿إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرًا لِمَن كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ﴾، [ق: 37]

"Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon." (Kaf: 37)



Pjesa e dytë: Virtyti (*el-ihsan*), meritat, shpërblimi dhe raporti i tij me ruajtjen e mjedisit

i) Meritat e tij

Islami urdhëron mirësi dhe thërret për përhapjen e virtyteve mes njerëzve. Ai shtron themelet e një mjedisi të shëndoshë moral. I Dërguari i Zotit, Muhammedi a.s. është mishërimi i këtij kodi. Kur'ani e përshkruan atë në shumë mënyra. Profeti u urdhërua të ruajë edukatën dhe mirësjelljen. Urdhri kur'anor vlen për të gjithë muslimanët. Zoti i madhërishëm thotë:

﴿وَلَا تَسْتَوِي الْحَسَنَةُ وَلَا السَّيِّئَةُ ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ﴾، [فصلت: ٣٤]

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet: 34)

Profeti ynë i dashur Muhammedi (*paqe pastë mbi të*) u dërgua për të përsosur virtytet morale. Kjo do të thotë se të dërguarit e mëparshëm të Zotit erdhën për të ftuar në adhurimin e Zotit pastaj për virtytet. Mirëpo, Muhammedi a.s.¹⁷ erdhi për të plotësuar suazën e virtyteve.

Ai a.s. ka thënë: “Në dashurinë, mëshirën dhe mirësinë e tyre janë si një trup: nëse njëra pjesë sëmuret, i tërë trupi ndan pagjumësinë dhe zjarminë e saj.”¹⁸

¹⁷ <http://www.islam-online.net/english/Science/2000/4/article1.shtml>, browsed:30.12.09

¹⁸ Sahih Muslim, 2586, Sahih al-Buhari, 6011.

Ai a.s. gjithashtu ka thënë: “Më i miri prej besimtarëve është më i miri prej tyre në moral. Dhe më të mirët prej tyre janë ata që janë më të mirë me gratë e tyre.”¹⁹

Ai a.s. ka theksuar se: “Askush prej jush nuk ka besuar plotësisht pa dashur për vëllain e vet atë që do për vete.”²⁰

Ai a.s. ka thënë: “Të mëshirshmit mëshirohen nga i Gjithmëshirshmi. Mëshironi në tokë që të mëshiroheni nga Zoti.”²¹

Po ashtu i dashuri ynë Muhammed a.s. ka thënë: “Zoti nuk ju gjykon sipas dukjes dhe pasurisë, por sipas zemrave dhe Ai shikon veprat e juaja.”²²

Karakteri i Profetit Muhammed është përmendur edhe në shpalljet e mëhershme. Buhariu ka përcjellë nga Ata ibn Jasari:

Takova Abdullah ibn Amr ibn el-Asin dhe e pyeta: "Tregomë rreth përshkrimit të të Dërguarit të Zotit që përmendet në Teurat." Ai u përgjigj, 'Po, për Allah, ai përshkruhet në Teurat me të njëjtat cilësi që i njeh Kur'ani: *O Profet! Ne të kemi dërguar si dëshmuar e sihariqdhënës, dhe paralamëruar dhe mbikëqyrës i të pamësuarve*. Ti je robi Im dhe i dërguari Im. Të kam quajtur el-Mutewekil (ai që i mbështetet Zotit). Nuk je as i pasjellshëm, as i vrazhdë, e as i zhurmshëm në pazare. Dhe nuk u bën keq atyre që të bëjnë keq, por vepron me ta me falje e mirësi. Zoti nuk do ta lërë atë (Profetin) të vdesë gjersa t'i drejtojë të kërrusurit duke u thënë: Nuk ka zot përveçse Zoti, me çka do të hapen sytë e verbër, veshët e shurdhët dhe zemrat e mbyllura.”²³

Mirësia lehtëson mirëkuptimin ndërnjerëzor dhe mpak mundësitë e fërkimit dhe konfliktit, që gëlojnë në çdo aspekt të jetës. Islami urdhëron mirësi ndaj të gjithë individëve, por ca më shumë ndaj disa kategorive të posaçme, sikurse jetimëve. Mirësia nuk duhet harruar kurrë as ndaj prindërve edhe kur plaken dhe bëhen barrë për dikë.

Buhariu ka përcjellë hadithin e Esma bint Ebu Bekrit, e cila tha:

“Më erdhi nëna me shpresë tek unë, dhe e pyëta Profetin: A ta trajtoj mirë? Ai u përgjigj: ‘Po.’ Ibn Ujejna ka thënë,²⁴ Atëherë Allahu shpalli:

¹⁹ *Musned Ahmad*, 7354, *al-Tirmidhi*, 1162.

²⁰ *Sahih al-Buhari*, 13, *Sahih Muslim*, 45.

²¹ *Al-Tirmidhi*, 1924, *Abu Davud*, 4941.

²² *Muslim*, 2564.

²³ *Sahih Al Buhari*, Volume: 3, Book Number: 34, Hadith Number: 335.

²⁴ *Ibid*, Volume: 8, Book Number: 73, Hadith Number: 9.

﴿لَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِّنْ دِيَارِكُمْ أَن تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ﴾، [المتحنة: ٨]

"Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët." (al-Mumtehineh: 8).

Zoti i madhërishëm thotë po ashtu:

﴿وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا إِنَّمَا يَبْغُ عِنْدَكَ الْكِبَرُ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أُفٍّ وَلَا تَنْهَرْهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا﴾، [الإسراء: 23]

"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti." (el-Isra': 23).

Kur'ani Fisnik i urdhëron muslimanët të flasin mirësisht tërë kohën, me gjithkënd. Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا﴾، [البقرة: 83]

"Folu mirësisht njerëzve" (el-Bekareh: 83).

Në raportin martesor, burrit i është dhënë përgjegjësia për ta mrojtur dhe siguruar gruan, dhe deri në njëfarë mase të jetë përgjegjës për veprimet e saj. Ai duhet të kryejë detyrat e tij ndaj saj me mirësi. Zoti e nxiti gjithashtu Profeti e Islamit, a.s., për të theksuar mirësinë mes besimtarëve në veprimet e tyre të përditshme:

﴿خُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ وَأَعْرِضْ عَنِ الْجَاهِلِينَ﴾، [الأعراف: 199]

"Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!" (el-A'raf: 199).

Të gjithë ata që kanë autoritet duhet jo vetëm të mishërojnë mirësi në sjelljen e tyre, por edhe t'i porosisin të tjerët. Autoriteti nuk duhet abuzuar kurrë në poste qeverie dhe administrimi. Nëse funksionarët nuk kanë dhembshuri për nevojat e popullit, politika mbetet e paqëndrueshme, duke shkaktuar despotizëm ose anarki:

﴿الَّذِينَ إِنْ مَكَّنَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ أَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ وَأَمَرُوا بِالْمَعْرُوفِ وَنَهَوْا عَنِ الْمُنْكَرِ
وَلِلَّهِ عَاقِبَةُ الْأُمُورِ﴾ [الحج:41]

“(Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zeqatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.” (el-Haxh:41).

Ndaj njerëzve të feve të tjera, Kur’ani Fisnik sugjeron tolerancë dhe mirësi si linja e preferuar e veprimit që duhet përvetësuar nga muslimanët. Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿وَلَا تُجَادِلُوا أَهْلَ الْكِتَابِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِلَّا الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ وَقُولُوا آمَنَّا بِالَّذِي أُنْزِلَ
إِلَيْنَا وَأُنْزِلَ إِلَيْكُمْ وَإِلَهُنَا وَإِلَهُكُمْ وَاحِدٌ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ﴾ [العنكبوت:46]

"Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: “Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si mysli-manë”.” (el-Ankabut: 46).

Islami synon të mbajë një barazpeshë të shëndoshë në shoqëri dhe në çdo aspekt të jetës njerëzore. Urdhëresat e tij kanë për qëllim të krijojnë raporte të shëndetshme dhe lidhje të ngushta mes njerëzve. Islami mëson se marrëdhëniet tona duhen ndërtuar mbi një themel mirësie e dhimbshurie. Profeti ynë i dashur Muhammedi a.s. ishte shembulli më i mirë në këtë çështje. Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ
وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ﴾
[آل عمران: ١٥٩]

"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Al-i Imran:159).

Le t'i refuzojmë ndikimet që na nxisin të përqendrohemi te materializmi, dhe t'i kthehemi mësimëve hyjnore të Islamit që bazohen në vlerat njerëzore të dashurisë dhe faljes. Në ajetet e mëposhtme koncepti i mirësisë dhe ndikimi i saj në ruajtjen e bashkimit, paqes, vëllazërisë, solidaritetit, dashurisë, pasionit dhe ruajtjes së mjedisit nga prapësitë dhe zullumqarët mund të shihet qartë. Zoti i Madhërishëm thotë:

1- ﴿وَأَنْفِقُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ وَأَحْسِنُوا إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ﴾،

[البقرة:195]

"Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit." (el-Bekareh: 195).

2- ﴿وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا

بِالْحُسْنَى﴾، [النجم:31]

"Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë." (en-Nexhm:31).

3- ﴿لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةٌ وَلَدَارِ الْآخِرَةِ خَيْرٌ وَلَنِعْمَ دَارُ الْمُتَّقِينَ﴾،

[النحل:30]

"Ata që bëjnë vepra të mira në këtë botë, do të kenë mirësi; në botën tjetër do të kenë edhe më të mira. Sa e mrekullueshme do të jetë shtëpia e atyre që i frikësohen Allahut!" (en-Nahl: 30)

4- ﴿إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ﴾، [النحل:128]

"Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë" (en-Nahl: 128).

5- ﴿وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا وَإِنَّ اللَّهَ لَمَعَ الْمُحْسِنِينَ﴾، [العنكبوت: 69]

"Ata që përpiqen për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!" (el-Ankabut: 69)

6- ﴿الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ﴾، [الملك:67]

"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh." (el-Mulk: 2)

7- ﴿إِنْ أَحْسَنْتُمْ أَحْسَنْتُمْ لِأَنْفُسِكُمْ وَإِنْ أَسَأْتُمْ فَلَهَا﴾ ، [الإسراء: 7]

"Nëse bëni mirësi, e keni bërë për veten tuaj. E, nëse bëni keq, ia keni bërë po vetes." (el-Isra':7)

ii) Shpërblimi i virtytit (el-ihsan)

Në Kur'anin Fisnik theksohet posaçërisht virtyti (el-ihsan), ngase ai është instrument i fuqishëm që e bën ndërveprimin njerëzor të frytshëm dhe pasuron bukurinë etike të raporteve shoqërore. Po ashtu, njerëzit nxiten në veprime fisnike mbi bazën e inkurajimit dhe shpërblimit që kjo sjell, duke ruajtur veten, familjen, shoqërinë, vendin dhe mjedisin e tyre nga keqbërja, zullumi ose njerëzit materialistë, sekularë, që nuk kanë asnjë lloj respekti për mësimet hyjnore kur'anore dhe konceptet sakrale. Aishja r.a. transmeton:

عَنْ عَائِشَةَ زَوْجِ النَّبِيِّ -صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ- أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ -صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ- قَالَ « يَا عَائِشَةُ إِنَّ اللَّهَ رَفِيقٌ يُحِبُّ الرَّفْقَ وَيُعْطِي عَلَى الرَّفْقِ مَا لَا يُعْطِي عَلَى الْعُنْفِ وَمَا لَا يُعْطِي عَلَى مَا سِوَاهُ ».

"I Dërguari i Zotit a.s. ka thënë: Vërtet, Allahu është i butë dhe e do butësinë dhe e shpërblen butësinë siç nuk shpërblen ashpërsinë, dhe nuk vë me të asgjë tjetër."²⁵

Aishja r.a. gjithashtu ka transmetuar se Profeti ka thënë:

²⁵ Sahih Muslim, 6273.

عَنْ عَائِشَةَ زَوْجِ النَّبِيِّ -صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ- عَنِ النَّبِيِّ -صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ- قَالَ « إِنَّ الرِّفْقَ لَا يَكُونُ فِي شَيْءٍ إِلَّا زَانَهُ وَلَا يُنْزَعُ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا شَانُهُ »

"Mirësia nuk gjendet kund pa i shtuar bukurisë dhe nuk tërhiqet nga dikund pa e bërë atë të metë."²⁶

Imam Malik bin Enesi në *Muwatta* tregon se Jahja i ka transmetuar se ai ka dëgjuar të Dërguarin e Zotit a.s. duke thënë:

عن مالك أنه قد بلغه ان رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: ((بعثت لأتمم حُسن الأخلاق))
"Jam dërguar për të përsosur karakterin."²⁷

Po ashtu, imam Maliku ka përcjellë nga Jahja ibn Sa'idi:

عن أم الدرداء عن أبي الدرداء قال : سمعت النبي صلى الله عليه وسلم يقول: ((ما من شيء يوضع في الميزان أثقل من حسن الخلق وإن صاحب حسن الخلق ليلبغ به درجة صاحب الصوم والصلاة))

"Kam dëgjuar se me këtë karakter të mirë njeriu mund të arrijë nivelin e atij që rri në namaz natën dhe etet nga agjërimi në vapë ditën."²⁸

Në ajetet e mëposhtme mund të shohim domethënien e shpërblimeve të tilla të përgatitura nga Zoti i Madhërishëm për shërbëtorët e Tij nëse i zbatojnë urdhëresat e Tij. Allahu i Lartësuar thotë në Librin e Tij fisnik:

1- ﴿هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ﴾ ، [الرحمن:60]

"A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?" (Rahman: 60)

2- ﴿لِّلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ﴾ ، [يونس:26]

"Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër! Fytyrat e tyre nuk do t'i mbulojë as errësira, as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë." (Yunus:26)

3- ﴿قُلْ يَا عِبَادِ الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا رَبَّكُمُ لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةٌ﴾ ، [الزمر:10]

²⁶ Po aty, 6274.

²⁷ *Mu'atta'*, 1st ed. 2003, Beirut, tr: Aisha Beëley, hadithr: 47.

²⁸ Ibid, 48.0, Good Character

"Thuaj: 'O robër besimtarë (të Allahut), frikësojuni Zotit tuaj! Ata që bëjnë mirë në këtë jetë, do të kenë të mira. Toka e Allahut është e gjerë. Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë'." (ez-Zumer: 10)

4- ﴿لِّلَّذِينَ أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةٌ وَلَدَارُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ وَلَنِعْمَ دَارُ الْمُتَّقِينَ﴾، [النحل: 30]

"Ata që bëjnë vepra të mira në këtë botë, do të kenë mirësi; në botën tjetër do të kenë edhe më të mira. Sa e mrekullueshme do të jetë shtëpia e atyre që i frikësohen Allahut!" (en-Nahl: 30).

5- ﴿لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحُسْنَى﴾، [النجم: 31]

"për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë." (en-Nexhm: 31).

6- ﴿هُم مَّا يَشَاءُونَ عِنْدَ رَبِّهِمْ ذَلِكَ جَزَاءُ الْمُحْسِنِينَ﴾، [الزمر: 34]

"Ata do të kenë çfarë të duan te Zoti i tyre. Ky është shpërblimi për punëmirët." (al-Zumar: 34)

7- ﴿إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ﴾، [المرسلات: 44]

"Kështu i shpërblejmë Ne ata, që bëjnë vepra të mira." (el-Murselat: 44)

8- ﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا﴾، [الكهف: 30]

"Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmirëve" (el-Kehf: 30)

9- ﴿وَاصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ﴾، [هود: 115]

"Dhe duro! Se Allahu, me të vërtetë, nuk e humb shpërblimin për punëmirët." (Hud:115)

10- ﴿وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا وَادْعُوهُ خَوْفًا وَطَمَعًا إِنَّ رَحْمَتَ اللَّهِ قَرِيبٌ مِّنَ الْمُحْسِنِينَ﴾ [الأعراف: 56]

"Dhe mos bëni çrregullime në Tokë, pasi është vënë rregulli, ndërsa Atij lutjuni me frikë dhe shpresë. Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve." (el-A'raf: 56)

11- ﴿فَأَتَابَهُمُ اللَّهُ بِمَا قَالُوا جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَذَلِكَ جَزَاءُ الْمُحْسِنِينَ﴾، [المائدة: 85]

"Për fjalët e tyre, Allahu do t'i shpërblejë me kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku ata do të qëndrojnë përgjithmonë. Ky është shpërblimi i punëmirëve", (el-Ma'ide: 85)

12- ﴿وَبَشِّرِ الْمُحْسِنِينَ﴾، [الحج: 37]
 "... Dhe, jepu lajmin e mirë të gjithë punëdrejtëve!" (el-Haxhxh:37)

13- ﴿وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ﴾، [آل عمران: 134]
 "të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit." (Al-i Imran:134)

14- ﴿فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاصْفَحْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ﴾، [المائدة: 13]
 "...pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit.." (el-Ma'ide:13)

15- ﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ﴾، [يوسف: 120]
 "...sepse Allahu nuk ua çon dëm përpjekjen punëmirëve" (Jusuf:120).

Pra, a është ndotja e lumejve me kimikate vepër ihsani? Absolutisht jo.

A është shkatërrimi dhe djegia e pyjeve jë akt ihsani? Absolutisht jo.

A është prishja e barazpeshës mes oksigjenit dhe ujit vepër e virtytshme? Absolutisht jo.

Po kështu, hedhja e plehrave në kazanin e gabuar nuk mund të konsiderohet vepër ihsani.

Mosmbajtja pastër e vetes, dhomës së gjumit, zyrës, punës, universitetit, rrugës, shtëpisë, parkut ... etj, a mund të konsiderohet vepër ihsani?

Përgjigjja është e thjeshtë dhe e saktë: jo!

﴿إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرًا لِمَنْ كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ﴾، [ق: 37]

" Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon." (Kaf: 37)



Pjesa e tretë: drejtësia (el-adl), meritat, shpërblimi dhe raporti i saj me ruajtjen e mjedisit

i) Meritat dhe shpërblimi i saj

Islami i siguron shumë të drejta njerëzore individit. Më poshtë vijojnë disa nga këto të drejta që Islami i mbron.

Jeta dhe prona e të gjithë qytetarëve në një shtet islam konsiderohen sakrale, qoftë personi musliman ose jo. Islami mbron gjithashtu edhe nderin. Prandaj, fyerja ose tallja e të tjerëve nuk lejohet. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Vërtet, gjaku, prona dhe nderi juaj janë të pacëneshë.” Racizmi nuk lejohet në Islam, sepse Kur’ani flet për barazi njerëzore me këto fjalë: Islami kundërshton favorizimin e disa individëve ose kombeve për shkak të pasurisë, pushtetit, ose racës së tyre. Zoti i ka krijuar qeniet njerëzore të barabartë me njëri tjetrin dhe ata dallojnë vetëm në bazë të besimin dhe përzotshmërisë. Profeti Muhammed a.s. ka thënë: “O njerëz! Zoti juaj është një dhe paraardhësi juaj (Ademi) është një. Arabi nuk është më i mirë se joarabi dhe joarab nuk është më i mirë se arabi, dhe i kuqi nuk është më i mirë se i ziu dhe i ziu nuk është më i mirë se i kuqi, përveçse në devotshmëri.”

Ndër problemet madhore që ndesh sot njerëzimi është racizmi. Bota e zhvilluar mund të çojë një jeri në hënë por nuk mund ta ndalojë njeriun nga të urryerit dhe të luftuarit e tjetrit. Që nga koha e Profetit, Islami ka ofruar një shembull të gjallë se si mund t’i jepet fund racizmit. Haxhi i përvitshëm në Mekë tregon vëllazërinë e vërtetë islame të mbarë racave dhe kombeve kur mbi 2 milionë muslimanë nga e gjithë bota vijnë në Mekë për të kryer haxhin. Muslimanët duhet të jenë të drejtë edhe me ata që i urrejmë, siç ka porositur Zoti:

﴿وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰٓ اَلَّا تَعْدِلُوْا اَعْدِلُوْا هُوَ اَقْرَبُ لِلتَّقْوٰى وَاتَّقُوا اللّٰهَ اِنَّ اللّٰهَ خَبِيْرٌۢ بِمَا تَعْمَلُوْنَ﴾، [المائدة: ٨]

"Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! " (el-Ma'ide:8)

Profeti a.s. ka thënë: “Kujdes nga padrejtësia sepse ajo do të jetë errësirë në Ditën e Gjykimit.”²⁹

²⁹ Muslimi, 1009, Buhariu, 2989.

Zoti Fuqiplotë e ka theksuar këtë koncept fisnik në shumë vende në Kur'an. Falë rëndësisë së tij në krejt gjithësinë dhe jetën njerëzore, Zoti ka zgjedhur ta quajë Veten, i Lartësuar qoftë, me këtë emër, sepse një nga emrat e bukur të Zotit është *el-adl*, që do të thotë *drejtësia*.

"... Kështu jeta është një demonstrim i shkëlqyer i urtisë dhe dijes së Zotit. Ai ua ka treguar njerzve rrugën e drejtë për ta vazhduar jetën mbi këtë planet. Ekziston një qëndrueshmëri dhe unitet i plotë në ligjet e gjithësisë. I tërë kozmosi është tejet homogjen dhe në barazpeshë. Përveç Krijuesit nuk ka askush fuqi për të ndërhyrë te ky sistem ose për t'ia ndryshar ligjet, të cilat mbështeten në drejtësi. Duke qenë pjesë e këtij sistemi, edhe njeriu duhet të veprojë drejt në sferën ku i është dhënë kontroll e fuqi, përndryshe do të veprojë kundër ligjeve të gjithësisë, si dhe natyrës së tij... Rezultati i kësaj mund të jetë fatkeqësi dhe shkatërime alarmuese në mjedis.

Pastërtia në Islam: Më pranë trupit njerëzor është nefsi i tij, vijuar nga mjedisi në të cilin ai jeton. Kështu, Islami e shqyrton mjaft thellë çështjen e pastërtisë së shpirtit dhe trupit, sepse ajo përbën thelbin e pamjes së jashtme dhe shëndetit. Zoti thotë:-

﴿قُلْ لَا يَسْتَوِي الْحَيُّ وَالطَّيِّبُ وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ الْحَيِّثِ فَاتَّقُوا اللَّهَ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾ [المائدة: 100]

“Thuaju: ‘Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes. Prandaj kijeni frikë Allahun, o njerëz me intelekt, me qëllim që të shpëtoni’.” (el-Ma’ideh:100)

Gjetiu, Kur’ani thotë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّىٰ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّىٰ﴾ [الأعلى: 14-15]

“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!” (al-A’la:14-15)

Shthurja, shpërbërja, çregullimet mendore dhe nervore, përversionet intelektuale dhe seksuale po ia brejnë trupin qytetërimit të sotëm duke shkatërruar kombe dhe individë, duke i ekspozuar njerëzit ndaj mënyrave të liga dhe të prishura të jetesës. Megjithatë, për sa kohë që njerëzimi ndjek ligjet e Krijuesit, të gjitha aspektet e jetës së tij në mjedis rrjedhin natyrshëm. Por nëse ndodhin devijime nga udha e caktuar prej Krijuesit, do të vijojnë të gjitha fatkeqësitë

shoqërore dhe mjedisore nga të cilat vuajnë njerëzit sot. Është në të mirën e gjërave që stili i të jetuarit nga njeriut të programohet sipas ligjeve të Krijuesit për ta shpëtuar njerëzimin nga katastrofat mjedisore..."³⁰

Në trajtesën e tij mbi raportin mes drejtësisë dhe mirësisë Profesor Hamid Ebu Zejd mendon se drejtësia:

"Është një koncept që zakonisht lidhet me barazinë në sytë e ligjit; pra që ligji duhet t'i trajtojë njëloj njerëzit që u përmbahen ligjeve dhe rregullave të tij, pavarësisht nga statusi i tyre shoqëror, politik, ose ekonomi. Etimologjikisht, rrënja '-d-l' përdoret në Kur'an në të gjitha format dhe variantet, si emër njëjës dhe shumës, si mbiemër, dhe si folje. Në njëjës, emri dhe mbiemri nuk përcjellin tamam të njëjtin kuptim. Emri nënkupton gjithmonë drejtësi. Si mbiemër do të thotë drejtkëndor, jo i shtrembër, i mirëbalancuar; pra ka të bëjë si me njerëzit ashtu edhe me sendet. Gurthemeli i konceptit kur'anor të drejtësisë gjendet në fragmentet ku drejtësia paraqitet si urdhëresë hyjnore nga Zoti. Shembulli që duhet analizuar është ajeti 16:90, ku drejtësia shoqërohet me ihsanin, pra bërjen e të mirës maksimale dhe sjelljen e mirë ndaj vetes dhe të tjerëve... Ndërlidhja mes drejtësisë dhe ihsanit në këtë ajet gjen domethënie të plotë në përkufizimin që i është bërë ihsanit nga Profeti: "t'i shërbesh Zotit tamam sikur ta shihje, se edhe ne më e shikofsh dot ti, të sheh Ai ty." Një shpjegim i tillë profetik e vendos ihsanin në gradën e të lartë të shërbimit të Zotit, edhe më lart se imani. Nëse ihsani dhe adli shoqërohen kështu, pozita e ihsanit i duhet atribuar semantikisht adlit. Drejtësia Hyjnore manifestohet kështu në krejt gjithësinë dhe shprehet në librin e shpalljes. Drejtësia është peshorja që mban gjithçka në ekuilibër, me përjashtim të njeriut, që ka lirinë të mosbindet, duke sjellë kështu çekuilibër në këtë botë. Në të gjitha rastet, jemi ne që përcaktojmë vendmbreritjen tonë këtu në tokë dhe në ahiret. Ky është koncepti kur'anor i drejtësisë."³¹

Në ajetet e mëposhtme mund të vërejmë qartë meritën dhe shpërblimin e Drejtësisë. Zoti Fuqiplotë thotë:

³⁰ Cf. Toshihiko Izutsu (1962): "Revelation as a Linguistic Concept in Islam". In: *Studies in Medieval Thought (The Japanese Society of Medieval Philosophy)* 5, 122-167, dhe www.islamicvoice.com/april.98/qur-sci.htm, broësed: 15.10.2009

³¹ Nga: <http://them.polylog.org/3/fan-en.htm>

1- ﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ﴾ [النحل:90]

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.” (en-Nahl:90)

2- ﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُمْ بِهِ إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا بَصِيرًا﴾ [النسا:58]

“Allahu ju urdhëron që amanetet t’jua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt. Vërtet, Allahu ju këshillon mrekullueshëm dhe vërtet, Allahu dëgjon çdo gjë e vështron të gjitha punët!” (al-Nisa:58)

3- ﴿وَإِنْ طَائِفَتَانِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا فَإِنْ بَغَتْ إِحْدَاهُمَا عَلَى الْأُخْرَىٰ فَقَاتِلُوا الَّتِي تَبْغِي حَتَّىٰ تَفِيءَ إِلَىٰ أَمْرِ اللَّهِ فَإِنْ فَاءَتْ فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا بِالْعَدْلِ وَأَقْسِطُوا إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ﴾ [الحجرات:9]

“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi..” (el-Huxhurat: 9)

4- ﴿أَوْفُوا الْكَيْلَ وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُخْسِرِينَ﴾ [الشعراء:181]

“Bëjeni drejt matjen dhe mos u bëni nga ata që hanë (në matje).” (al-Shu’ara: 181)

5- ﴿وَأَقِيمُوا الْوَزْنَ بِالْقِسْطِ وَلَا تُخْسِرُوا الْمِيزَانَ﴾ [الرحمن:9]

“Prandaj matni drejt e mos hani në peshë!” (Rahman:9).

6- ﴿يَا قَوْمِ أَوْفُوا الْمِكْيَالَ وَالْمِيزَانَ بِالْقِسْطِ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ وَلَا تَعْتُوا فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ﴾ [هود:85]

“O populli im, matni drejt në litër dhe kantar, mos ua hani njerëzve hakun e tyre dhe mos bëni ngatërresa në Tokë!” (Hud:85).

7- ﴿قُلْ أَمَرَ رَبِّي بِالْقِسْطِ وَأَقِيمُوا وُجُوهَكُمْ عِندَ كُلِّ مَسْجِدٍ وَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ ۚ كَمَا بَدَأَكُمْ تَعُودُونَ﴾، [الأعراف: 29]

“Thuaj: ‘Zoti im urdhëron drejtësi. Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami e lutjuni Atij sinqerisht, me besim të pastër e të vërtetë! Siç ju ka krijuar së pari, ashtu do t’ju ringjallë.’” (el-A’raf: 29).

8- ﴿شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ﴾، [آل عمران: 18]

“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.” (Al-i Imran:18)

9- ﴿وَنَضَعُ الْمَوَازِينَ الْقِسْطَ لِيَوْمِ الْقِيَامَةِ فَلَا تُظْلَمُ نَفْسٌ شَيْئًا وَإِنْ كَانَ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِنْ خَرْدَلٍ أَتَيْنَا بِهَا وَكَفَى بِنَا حَاسِبِينَ﴾ [الأنبياء: 47]

“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (el-Enbija’:47)

10- ﴿إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَيَقْتُلُونَ النَّبِيَّ بِغَيْرِ حَقٍّ وَيَقْتُلُونَ الَّذِينَ يَأْمُرُونَ بِالْقِسْطِ مِنَ النَّاسِ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ﴾ [آل عمران: 21]

“Lajmëroi ata që mohojnë shpalljet e Allahut, vrasin profetët padrejtësisht dhe vrasin edhe ata që urdhërojnë të veprohet me drejtësi, për dënimin e dhembshëm që i pret.” (Al-i ‘Imran: 21)

11- ﴿وَفُضِّيَ بَيْنَهُمْ بِالْقِسْطِ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ﴾ [يونس: 54]

“por do të gjykohen me të drejtë e nuk do t’u bëhet padrejtësi” (Junus: 54)

12- ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَا نُ قَوْمٍ عَلَىٰ أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ﴾، [المائدة: 8]

“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju” (al Ma'idah: 8)

13- ﴿وَإِنْ حَكَمْتَ فَأَحْكُم بَيْنَهُم بِالْقِسْطِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ﴾ ، [المائدة:42]
“E, nëse i gjykon, gjykoji me drejtësi! Vërtet, Allahu i do të drejtët.” (el-Ma'idah:42).

14- ﴿لِيَجْزِيَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ بِالْقِسْطِ﴾ ، [يونس:4]
“që t'i shpërblejë me të drejtë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira” (Junus:4)

15- ﴿لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنْزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ﴾ ،
 [الحديد:25]
“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt...” (el-Hadid: 25)

16- ﴿وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ حَتَّىٰ يَبْلُغَ أَشُدَّهُ وَأَوْفُوا الْكَيْلَ وَالْمِيزَانَ بِالْقِسْطِ لَا تَكْلَفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدِلُوا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ﴾ ،
 [الأنعام:152]

“Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Kryejeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësojani besën e dhënë Allahut! Këto ju porosit Ai që të mos harroni.” (el-An'am: 152)

17- ﴿قُلْ أَمَرَ رَبِّي بِالْقِسْطِ﴾ ، [الأعراف:29]
“Thuaj: “Zoti im urdhëron drejtësi.” (el-A'raf: 29)

ii) Raporti i saj me ruajtjen e mjedisit

Nga çfarë thamë mund të kuptojmë rëndësinë e këtij koncepti Hyjnor. Nuk do të kishte paqe e as zgjidhje për krizën tonë mjedisore dhe shoqërore pa iu kthyer themelit të Islamit: Kur'anit dhe Sunnetit. Me ta marrë besimtarët seriozisht këtë koncept hyjnor dhe zbatuar atë në jetën e përditshme, nuk do të kishte dëmtim të të tjerëve, helmim, ndotje, djegie, humbje të barazpeshës mes oksigjenit dhe ujit, lëndë toksike, armë kimike të shkatërrimit në masë, e as bomba atomike.

Nëse këto koncepte kur'anore zbatohen në ndërveprimet tona të përditshme në të gjitha aspektet e jetës sonë, Zoti me urtinë dh mëshirën e Tij do të sjellë lumturi dhe bekim për shërbëtorët e Tij mbi tokë. Jeta në këtë botë nuk kërkon prej nesh përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë, të bombave atomike, të intoksikuesve dhe kimikateve. Historia na tregon se brezat e mëparshëm nuk i kishin këto armë dhe jeta e tyre shkonte për së mbari.

Media e sotme shkaktojnë panik dhe frikë mes njerëzve anekënd botës. Thua se çdo kanal diskuton çështjen e sanksioneve kundër Iranit, Koresë së Veriut dhe disa vendeve të tjera për zotërimin dhe zhvillimin e aftësive të tyre atomike. Ata shpërfillin vendet e vogla që kanë dhe zhvillojnë teknologji të tilla. Nuk ka drejtësi dhe barazi në mohimin që i bëjnë çështjeve kaq të rrezikshme. Kur'ani Fisnik thotë se ajo që ëshë e keqe dhe e dëmshme është e tillë për çdo komb, jo vetëm popuj dhe kombe të caktuara. Këtu qëndron rëndësia e raportit të këtij koncepti sakral me ruajtjen e mjedisit tonë të mrekullueshëm.

Kështu që ndotja e lumenjve me kimikate a konsiderohet akt drejtësie, apo virtyti? Absolutisht jo.

Shkatërrimi dhe djegia e pyjeve a konsiderohet vepër e drejtë dhe e virtytshme? Absolutisht jo.

Zhbalancimi i nivelit të oksigjenit dhe ujit, a është veprim i drejtë dhe i virtytshëm? Absolutisht jo.

Vendosja e plehrave në pika të papërshtatshme nuk mund të konsiderohet akt drejtësie dhe virtyti!

Mosmbajtja e pastërtisë personale, të dhomës së gjumit, shtëpisë, zyrës, punës, universitetit, rrugës ... etj., a mund të quhet sjellje e virtytshme ose e virtytshme?

Përgjigjja është shumë e thjeshtë: jo !

﴿إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرًا لِمَن كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ﴾، [ق: 37]

"Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon." (Kaf: 37)

Le të përpiqemi për një mjedis më të pastër e më të mirë, dhe Zoti Fuqiptotë e di më mirë.



PËRFUNDIM

Më në fund, me bekimin e Zotit të madhërishëm arrita në fund të këtij punimi. Pa ndihmën dhe mirësinë e Tij nuk do të kisha qenë në gjendje ta përfundoja. I lutem dhe e falënderoj Atë që shpërblimi i këtij kontributi të përunjët të ruhet për Ditën e Gjykimit. Pajtohem me disa dijetarë të Islamit në këtë përfundim se Islami nuk përbën ndonjë fjalë magjike që mund të shqiptohet për të zgjidhur të gjitha problemet. Islami si fe ka shumë vështirësi kur vjen çështja te prakika, pa përmendur ato që kanë dalë në pah katërmbëdhjetë shekujve të fundit nga keqkuptimi, keqinterpretimi dhe keqpërdorja.

Islami mund të ketë kuptim nëse merret si sistem i plotë shpirtëror, shoqëror, ekonomik, lokal dhe global, dhe përdoret në një mënyrë që e bën të zbatueshëm brenda nocionit të "nënshtrimit" në paradigmen e teuhidit ose duke iu referuar "Kriterit të Mesit – Kur'anit dhe Sunnetit", që sundon tërë jetën njerëzore. Ky punim pohon se Islami mund të ofrojë truall të vlefshëm për zgjidhjen e jo vetëm problemit mjedisor, por edhe të problemeve të tjera shoqërore, ekonomike, politike, globale, individuale, etike, morale dhe shpirtërore. Megjithatë, punimi nënvizon Islamin si truall i rëndësishëm potencial për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga ku mund të vazhdojë ligji ndërkombëtar. Në Islam marrëdhënia e njerëzimit me mjedisin është pjesë e ekzistencës shoqërore, një ekzistencë e mbështetur në faktin se gjithçka mbi tokë adhuron dhe i bidnet Zotit të Madhërishëm.

Uesselamu Aleikum ue Rahmetullahi ue Barakatuhu

Juaji në Islam

Dr. Hfz. Hajredin Hoxha, Kosovë

Doktor në tefsir**05.09.2010****BIBLIOGRAFI**

1. Al Qur'an Al Karim (The Noble Qur'an) – English Translation of its meanings, King Fahd Complex, Al Madina Al Munawara, 2008.
2. *Al-Tirmizi*, (2001), Maktabatu Wahba, Cairo.
3. Audi, Robert; (1995) *The Cambridge Dictionary of Philosophy*, Cambridge University Press,
4. *Back to the Qur'an and Sunnah* - (2002) *A Comparative study of the responses of Hasan Hanafi – Abid Al Jabiri and Nurcholish Madjid*, - A Ph.D. dissertation written by: Yudia Wahyudi, The Institute of Islamic Studies, McGill University, Montreal, Canada,
5. Beaumont, P., Blake, G.H. & Wagstaff, J.M. (1978) *The Middle East, A Geographical study* (London, Wiley).
6. Cf. Toshihiko Izutsu (1962): "*Revelation as a Linguistic Concept in Islam*". In: *Studies in Medieval Thought* (The Japanese Society of Medieval Philosophy) 5, 122-167.
7. Cf. William A. GRAHAM (1993): *Beyond the written words: oral aspects of scripture in the history of religion*. Cambridge.
8. *Islamism and the Quest for Alternative Modernities*, (1998), A Ph.D. dissertation written by: Bahrooz Ghamari - Tabrizi, Santa Cruz - University of California.
9. *Islamism and the Quest for Alternative Modernities*, a Ph.D. dissertation written by: Bahrooz Ghamari- Tabrizi, Santa Cruz -University of California, June 1998
10. Izzidien, M. (1990) *Islamic environmental ethics, law and society*, in: J.R. Engel & J.G. Engel (eds) *Ethics of Environment and Development* , (London, Belhaven).
11. *Juan de Segovia and Western Perspectives on Islam in the Fifteenth Century*, (2002), A Ph.D, dissertation, written by: Anne Marie Wolf, University of Minnesota,
12. Mawil Izzi Dien , *Journal of Beliefs & Values* No 1,(1997), Carfax University of Wales - Lampeter,. △
13. *Mosnad Ahmad*, (1998), Dar Al Shuruk, Cairo, Egypt.

14. Muhammad bin Abdullaah As-Suhaym, *Islam: Its Foundations And Concepts*, Translated by, Abdur-Raafi Adewale Imaam, Under The Supervision of Translation and Publication Division, Islaamic Propagation And Education Committee, Muslim World League, Al-Madinah Al-Munawwarah
15. *Muwatta' of Imam Malik ibn Anas*, 1st edi. (2003), Beirut, Lebanon, Translated by: Ustadha Aisha Bewley, hadith Number: 47.0 Good Character
16. Nasr, S.H. (1978) *Islamic Cosmological Doctrine*, (London, Thames and Hudson).
17. Qutb, Sayid; *In the Shade of The Qur'an*, Maktabah Booksellers and Publishers, Birmigham-United Kingdom, 2009,
18. Qutb, Sayid; *Milestones-Meá'lim fi Al Tariq*, Edited by: A.B. El Mehri, Maktabah Booksellers and Publishers 2009, Birmigham-United Kingdom
19. *Saheeh Al-Buhari*, (2004), 1st edi, Dar Al Ma'rifah, Jeddah, Kingdom of Saudi Arabia
20. *Saheeh Muslim*, (2000), 2nd edit, Dar Al Bashair, Beirut, Lebanon
21. Sterling, S.R. (1990) *Towards an ecological world view* in: J.R.Engel & J.G. Engel, (eds) *Ethics of Environment and Development*, (London, Belhaven).
22. Sterling, S.R. (1990), *Towards an Ecological World view* in: J.R.Engel & J.G. Engel, (eds) *Ethics of Environment and Development*, (London, Belhaven).
23. Veslind P.J. (1993) *The Middle East's Water*, National Geographic Magazine, 183, 5.
24. Wuthnow, Robert; (1998), *The Encyclopedia of Politics and Religion*, Rutledge, United Kingdom, London,
25. <http://www.captiveminds.org/env/ecome>,
26. http://www.lamp.ac.uk/trs/staffgallery/mawil_paper.html
27. <http://www.islamset.com/hip/Al-Fangary.html#6>
28. <http://www.islam-online.net/english/Science/2000/4/article1.shtml>,
29. [http://www.dawn.com/wps/wcm/connect/dawn-content-](http://www.dawn.com/wps/wcm/connect/dawn-content-library/dawn/the-newspaper/editorial/islamic-concept-of-kindness-859)
30. [library/dawn/the-newspaper/editorial/islamic-concept-of-kindness-859](http://www.dawn.com/wps/wcm/connect/dawn-content-library/dawn/the-newspaper/editorial/islamic-concept-of-kindness-859)
31. <http://www.islamicvoice.com/april.98/qur-sci.htm>,
32. <http://them.polylog.org/3/fan-en.html>,

